

V E N D I M
Nr.269, datë 7.6.1993

PËR PRISHJEN E NDËRTIMEVE TË KUNDËRLIGJSHME

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pranë këshillave të rretheve të ngrihen komisionet për rivendosjen e gjendjes dhe prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme. Komisionet do të kenë në përbërjen e tyre sekretarët e bashkive, përfaqësues nga prokuroria e rrethit, dega e rendit publik, seksionet e urbanistikës dhe seksionet e ndërtim-komunales. Kryetari i komisionit do të jetë kryetari i këshillit të rrethit.

2. Brenda datës 30 qershor 1993, këshillat e rregullimit të territorit dhe komisionet përkatëse të çdo rrethi të evidencojnë të gjitha ndërtimet e kundërligjshme, duke specifikuar rastet e dhënies së paligjshme të shesheve të ndërtimit, lejet e paligjshme të ndërtimit dhe zëniet arbitrare të truallit.

3. Brenda datës 30 qershor, komisionet në rrethe të evidencojnë rastet kur ndërtimet e paligjshme janë pasojë e veprimeve të punonjësve të organeve të pushtetit lokal dhe të bëjnë denoncimin në organet e prokurorisë sipas klasifikimit të veprës penale.

4. Brenda datës 15 korrik 1993, këshillat e rregullimit të territorit në rrethe të njoftojnë me shkrim qytetarët kundërvajtës që të prishin vetë ndërtimet e paligjshme 15 ditë nga data e njoftimit. Në rast se qytetarët nuk i prishin vetë, komisioni organizon punën për prishjen e të gjitha objekteve të paligjshme, me shpenzimet e kundërvajtësve.

5. Për zbatimin e këtij vendimi këshillave të rretheve u akordohet nga fondi rezervë i buxhetit një fond prej 20 milionë lekësh sipas pasqyrës së bashkëngjitur, për të përballuar shpenzimet për pagat e specialistëve dhe mjetet e mekanizuara për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme.

6. Gjobat dhe të ardhurat e tjera do të derdhen: 15 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 85 për qind në buxhetin lokal.

7. Për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Mbrojtjes do të vënë në dispozicion të komisioneve grupe civilësh, të specializuara për prishjen e ndërtimeve, me gjithë mjetet dhe makineritë e nevojshme. Këto grupe, të shkëputura nga detyra aktuale dhe me fond të veçantë pagash, do të funksionojnë pranë ndërmarrjeve të sistemit komunal që janë në vartësi të organeve të pushtetit lokal.

Pagat e specialistëve do të përcaktohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

8. Për të kontrolluar zbatimin e këtij vendimi nga këshillat e rregullimit të territorit dhe komisionet e ngritura për këtë qëllim krijohet komisioni qendror i rivendosjes së gjendjes për ndërtimet e kundërligjshme, i kryesuar nga ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe i përbërë nga ministri i Rendit Publik, prokurori i Përgjithshëm, zëvendësministri i Financave dhe i Ekonomisë dhe zëvendësministri i Mbrojtjes.

9. Komisioni qendror i paraqet Këshillit të Ministrave propozime për masat që duhen marrë ndaj kryetarëve të këshillave të rretheve, të cilët nuk e zbatojnë këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

SHPËRNDARJA E FONDEVE PËR PRISHJEN E NDËRTIMEVE TË KUNDËRLIGJSHME SIPAS RRETHEVE

Nr. Rrethi

Fondi i akorduar në lekë

1. Tirana (bashkia+rrethi)	2.000.000
2. Durrësi	1.200.000
3. Vlora	1.700.000
4. Shkodra	1.200.000
5. Malësi e Madhe	200.000
6. Elbasani	1.200.000
7. Korça	1.200.000
8. Fieri	700.000
9. Kavaja	600.000
10. Tropoja	200.000
11. Puka	300.000
12. Kukësi	500.000
13. Hasi	200.000
14. Lezha	500.000
15. Mirdita	200.000
16. Peshkopia	300.000
17. Bulqiza	150.000
18. Mati	200.000
19. Kruja	300.000
20. Laçi	300.000
21. Lushnja	500.000
22. Peqini	200.000
23. Librazhdi	200.000
24. Pogradeci	700.000
25. Gramshi	400.000
26. Berati	700.000
27. Kuçova	150.000
28. Mallakastra (Ballshi)	150.000
29. Tepelena	300.000
30. Skrapari	150.000
31. Devolli (Bilishti)	100.000
32. Erseka (Kolonja)	100.000
33. Përmeti	500.000
34. Gjirokastra	700.000
35. Saranda	1.500.000
36. Delvina	500.000